

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **611-26-3115-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **“Shërbime profesionale, administrative dhe shërbime të mirëmbajtjes”**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>VECTOR CLEAN SH.P.K.</b>
NUI	<b>811913616</b>
Adresa	<b>Rr Motrat Qiriazi</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>048555558</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Astrit Hajdari</b>
Adresa elektronike	<b>infovectorclean@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>17.05.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**“Shërbime profesionale, administrative dhe shërbime të mirëmbajtjes”**

Ne si Operator Ekonomik parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Glllogocit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime profesionale, administrative dhe shërbime të mirëmbajtjes” me nr. të prokurimit 611-26-3115-2-2-1, për shkak të shkeljeve serioze të Ligjit për Prokurimin Publik dhe refuzimit të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim.

Dosja e tenderit përmban kritere diskriminuese, joproporcionale dhe favorizuese, të cilat kufizojnë konkurrencën dhe cenojnë trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Në mënyrë të veçantë, janë përzier artificialisht shërbime inxhinierike, administrative dhe operative në një kontratë të vetme, janë kërkuar certifikime dhe përvojë specifike të orientuara drejt operatorëve të caktuar ekonomikë, është përdorur pa bazë ligjore afati i shkurtuar, si dhe janë përcaktuar elemente që në substancë paraqesin angazhim personeli me orar të rregullt pune dhe jo kontratë klasike shërbimi.

Autoriteti Kontraktues, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk ka trajtuar në mënyrë konkrete pretendimet e ngritura dhe nuk ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm ligjor lidhur me proporcionalitetin e kritereve, ndikimin e tyre në konkurrencë dhe mungesën e ndarjes së shërbimeve sipas natyrës së tyre.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP aprovimin e ankesës dhe anulimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues, si dhe kthimin e dosjes së tenderit në rishqyrtim dhe rihartim në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Ne si Operator Ekonomik, me interes për këtë aktivitet të prokurimit, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Glllogcit, në përputhje me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime profesionale, administrative dhe shërbime të mirëmbajtjes” me nr. të prokurimit 611-26-3115-2-2-1.**

**Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar brenda afatit ligjor dhe ka ngritur pretendimet lidhur me:**

**kriteret diskriminuese dhe joproportionale,  
kufizimin e konkurrencës,  
përzjerjen artificiale të shërbimeve me natyra të ndryshme,  
përdorimin e afatit të shkurtuar pa bazë ligjore,  
si dhe elementet që në substancë paraqesin angazhim personeli dhe jo kontratë klasike shërbimi.**

**Autoriteti Kontraktues me vendim të datës 08.05.2026 e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka lejuar vazhdimin e aktivitetit të prokurimit.**

**Bashkëngjitur kësaj ankese gjendet:**

**kopja e kërkesës për rishqyrtim, si dhe vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- Neni 1 Qellimi  
Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Neni 28: Specifikimet teknike
- Neni 51: Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 56: Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e

Kontratave

- Neni 64: Dëshmitë e kërkesave
- Neni 69: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Gjithashtu janë shkelur dispozitat përkatëse të:

- Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar)
- Udhëzuesit Nr. 001/2023 dhe Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik

Në mënyrë të veçantë, Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar në mënyrë konkrete dhe individuale pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim, por ka dhënë përgjigje të përgjithshme dhe deklarative, pa analizë të mjaftueshme ligjore dhe faktike lidhur me proporcionalitetin e kriterëve, kufizimin e konkurrencës, ndarjen e shërbimeve sipas natyrës së tyre dhe efektin diskriminues të kërkesave të dosjes së tenderit.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Komuna e Gllogocit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka inicuar procedurën e prokurimit me titull Shërbime profesionale, administrative dhe shërbime të mirëmbajtjes me nr. të prokurimit 611-26-3115-2-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit, në formën aktuale të hartuar në dosjen e tenderit, është në kundërshtim me dispozitat dhe parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, duke cenuar trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, proporcionalitetin, konkurrencën efektive dhe transparencën në procedurë.

Nga analiza e dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike rezulton se Autoriteti Kontraktues ka hartuar kriteret dhe kërkesa të cilat, në kombinim me njëra-tjetrën, krijojnë efekt diskriminues dhe favorizues për operatorë të caktuar ekonomikë, duke kufizuar pjesëmarrjen reale në këtë aktivitet të prokurimit.

Në mënyrë të veçantë, Autoriteti Kontraktues ka përzier artificialisht kategori krejtësisht të ndryshme të shërbimeve në një kontratë të vetme, konkretisht:

shërbime inxhinierike dhe të mbikëqyrjes së projekteve,

shërbime administrative dhe raportuese,

si dhe shërbime operative dhe mirëmbajtëse.

Një strukturë e tillë nuk përfaqëson nevojë të unifikuar kontraktuale, por krijon efekt kufizues në konkurrencë dhe pamundëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të specializuar sipas profileve përkatëse.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me mosndarjen e këtyre shërbimeve në LOT-e të veçanta, ndonëse natyra e tyre është qartazi e ndashme dhe e pavarur nga njëra-tjetra.

Gjithashtu, kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, përfshirë: kërkesat për menaxhim të kontratave vetëm në institucione publike, kërkesat për certifikime specifike, certifikimin në sistemin PIP, numrin e kontratave të menaxhuara, dhe kombinimin e licencave, përvojës dhe profileve profesionale, janë të hartuara në mënyrë joproporcionale dhe krijojnë avantazh për operatorë ekonomikë të caktuar që tashmë posedojnë strukturë identike të angazhimit në institucione publike.

Autoriteti Kontraktues po ashtu ka përdorur procedurë me afat të shkurtuar pa ekzistimin e rrethanave objektive dhe të paparashikueshme që do të arsyetonin një veprim të tillë. Skadimi i kontratës ekzistuese është situatë e parashikueshme dhe nuk mund të konsiderohet urgjencë sipas kuptimit të LPP-së.

Një element veçanërisht shqetësues në këtë procedurë është fakti se në paramasë dhe specifikime teknike është përcaktuar angazhim i personelit me orar të rregullt 08:00:16:00, prezencë fizike në objektet komunale dhe kryerje të detyrave operative ditore.

Në mungesë të deliverables konkrete dhe rezultateve të matshme kontraktuale, kontrata në substancë reduktohet në sigurim personeli për nevoja të brendshme institucionale dhe jo në ofrim të shërbimeve të mirëfillta sipas natyrës së kontratave publike të shërbimit.

Përkundër pretendimeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues në vendimin refuzues nuk ka trajtuar në mënyrë konkrete dhe individuale pretendimet e operatorit ekonomik, por ka dhënë vetëm arsyeime të përgjithshme dhe deklarative pa analizë konkrete mbi proporcionalitetin, ndikimin në konkurrencë dhe domosdoshmërinë

reale të kritereve të vendosura.

Për këto arsye, konsiderojmë se dosja e tenderit dhe vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim janë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe cenojnë parimet themelore të konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit në prokurim publik.

Në vijim të kësaj Ankese, parashtrojmë pretendimet konkrete ankimore mbi shkeljet e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave të zbatueshme, të evidentuara në këtë procedurë të prokurimit, si dhe në vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

### **Pretendimi 1**

Autoriteti Kontraktues gjatë hartimit të dosjes së tenderit, dhe specifiku kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale, i ka orientuar kërkesat në mënyrë të tillë që favorizojnë operatorin ekonomik i cili aktualisht ka kontratë me Autoritetin Kontraktues dhe të cilit i skadon kontrata ekzistuese.

Këto kërkesa janë përshtatur me specifikat, trajnimet dhe certifikimet që posedojnë personat aktualisht të angazhuar, duke qenë në të njëjtën kohë të tepruara, diskriminuese dhe favorizuese, me efekt të drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës.

Në këtë situatë lind pyetja se cili është qëllimi i shpalljes së procedurës së hapur kur kriteret në substancë e orientojnë procesin drejt një operatori të vetëm. Në rrethana të tilla, një procedurë e hapur humb karakterin e saj konkurrues dhe efektiv.

Te kërkesa për inxhinier të diplomuar apo master në drejtimin konstruktiv me minimum 3 vite përvojë pune dhe menaxhim të së paku 5 kontratave nga institucione publike, paraqet kriter diskriminues dhe joproporcional, veçanërisht duke marrë parasysh se kohëzgjatja e kontratës është vetëm 6 muaj.

Kufizimi i përvojës vetëm në institucione publike dhe kërkesa për numër minimal kontratash në raport me kohëzgjatjen e kontratës bie ndesh me parimet e LPP-së.

Autoriteti Kontraktues nuk duhet të keqperdor pozicionin e sajë në lidhje me diskrecionin për vendosjen e Kritereve që duhet përmbushur. Kërkesat duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe nuk duhet të jenë të ekzagjeruara në mënyrë që të kufizojnë konkurrencën apo të favorizojnë operatorë të caktuar ekonomik. Ligji i

Prokurimit Publik përcakton qartë se parimet themelore janë barazia, jo-diskriminimi dhe transparenca.

Çdo kërkesë që nuk ka lidhje direkte me natyrën e kontratës dhe që kufizon konkurrencën bie ndesh me këto parime dhe krijon kushte për rritje artificiale të çmimeve.

**Të gjitha kërkesat duhet të jenë proporcionale dhe të arsyeshme, dhe në asnjë rrethanë të mbingarkuara, sepse kjo krijon avantazh për operatorë të caktuar ekonomik.**

Në përputhje me nenin 7 të LPP-së, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm apo në të mirë të një apo më shumë operatorëve ekonomik

Në veçanti, kërkesa për certifikim në siguri dhe shëndet në punë dhe licencim nga Oda e Inxhinierëve, në kombinim me kërkesat e tjera, **e shndërron kriterin nga profesional në selektiv dhe kufizues.** Po ashtu, kërkesa për menaxhim të së paku 5 kontratave nga institucione publike është diskriminuese pasi përjashton përvojën ekuivalente në sektorin privat apo projekte të ngjashme.

Pra, i nderuar anëtar i Bordit të OSHP-së,

Autoriteti kontraktues ka kombinuar certifikime dhe licencime shumë specifike, marrë për bazë natyrën dhe kohëzgjatjen e parashikuar për këtë aktivitet, ku në emer të "nevojave" dhe kërkesave, ka shkelur ligjin duke favorizuar OE të caktuar, dhe duke na diskriminuar ne si OE me interes për këtë aktivitet. Në këtë formë, kërkesat nuk janë më **kritere profesionale**, por, mekanizëm kufizues dhe selektiv.

## **Pretendimi 2**

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një person me diplomë bachelor, minimum 1 vit përvojë pune dhe certifikim për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontraktorëve.

Kjo kërkesë është joproportionale dhe nuk është e lidhur në mënyrë të qartë me objektin e kontratës, pasi nuk është sqaruar se për cilën pjesë të shërbimeve është i nevojshëm një certifikim i tillë.

Në këtë mënyrë, kërkesa krijon efekt kufizues në konkurrencë dhe favorizon operatorë të caktuar ekonomikë që tashmë kanë bashkëpunim me institucionin. AK gjatë hartimit të kërkesave është kujdesur ti paraqes si kërkesa minimale të gjitha certifikimet që kan

zyrtarët e sajë, qe tashme janë po me të njëjtën formë të angazhuar.

### **Pretendimi 3**

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar person teknik të ndërtimtarisë të certifikuar për sistemin PIP, me minimum 5 vite përvojë dhe **përvojë në menaxhim të së paku 5 kontratave nga institucione publike**. Ky kriter është diskriminues dhe kufizues, pasi sistemi PIP është i ndërlidhur me institucione publike dhe në praktikë e kufizon konkurrencën vetëm tek persona të ekspozuar në kontrata publike.

Sistemi PIP është sistem specifik institucional dhe përdoret kryesisht nga institucione publike, çka automatikisht kufizon konkurrencën vetëm tek persona që tashmë kanë qenë të angazhuar në institucione publike apo tek operatorë që aktualisht kanë kontrata të ngjashme me komuna apo ministri. Në këtë rast, Oe qe është favorizuar nga AK, është i paisur me këtë sistem.

Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar domosdoshmërinë e këtij certifikimi për realizimin e kontratës, vetëm në menyrë deklarative.

### **Pretendimi 4**

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar teknik të ndërtimtarisë apo arkitekturës me minimum 1 vit përvojë pune, si dhe person me arsim të lartë me minimum 1 vit përvojë pune, pa përcaktuar qartë natyrën konkrete të angazhimit, përgjegjësitë dhe rezultatet e pritshme nga këto pozita.

Kjo mungesë qartësie bie ndesh me parimin e transparencës dhe krijon hapësirë për interpretim subjektiv gjatë vlerësimit të ofertave.

### **Pretendimi 5**

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar listë të stafit teknik prej 3 punëtorëve të mirëmbajtjes, me shkollim minimal të mesëm, kontrata pune/parakontrata dhe deklarata nën betim. Përfshirja e stafit të mirëmbajtjes në të njëjtën kontratë me profile inxhinierike dhe administrative paraqet përzierje artificiale të shërbimeve.

**Ky fakt tregon se objekti real i kontratës është sigurimi i stafit operativ për nevoja të brendshme institucionale dhe jo kontraktim shërbimesh me rezultate të matshme.**

Në paramasë dhe specifikim teknik, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar qartë orarin e punës 08:00-16:00 për personelin e angazhuar, si dhe prezencë fizike në institucion. Ky element është jashtë natyrës së një kontrate shërbimi dhe përbën karakteristikë tipike të marrëdhënies së punës.

Në prokurim publik kontraktohen shërbime dhe rezultate konkrete, e jo punonjës me orar të rregullt brenda institucionit. Në këtë rast, AK nuk ka përcaktuar deliverables, rezultate të matshme apo indikatorë performance, por ka kërkuar prezencë fizike dhe angazhim ditor brenda institucioneve komunale.

Kjo dëshmon se kontrata në substancë paraqet dyshime për punësim të fshehur përmes operatorit ekonomik dhe shmangie të procedurave të rregullta të rekrutimit publik.

Në bazë të të gjitha fakteve dhe argumenteve të paraqitura në këtë ankesë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të:

**ANULOJË** procedurën e prokurimit në formën aktuale, si të kundërligjshme dhe kufizuese të konkurrencës, ose

**OBLIGOJ** Autoritetin Kontraktues të bëjë rishikimin e plotë të dosjes së tenderit duke eliminuar kriteret diskriminuese, joproporcionale dhe kufizuese, si dhe të

**OBLIGOJ** Autoritetin Kontraktues të ndajë shërbimet sipas natyrës reale të tyre (LOT-e të veçanta), si dhe

**OBLIGOJ** Autoritetin Kontraktues të zgjatë afatin për ofertim dhe të eliminojë procedurën me afat të shkurtuar në kundërshtim me ligjin.

Paralelisht, për shkak të shkeljeve të evidentuara në këtë procedurë, ne rezervojmë të drejtën për të njoftuar institucionet relevante mbikëqyrëse të prokurimit publik, si dhe organet profesionale përkatëse, në lidhje me përdorimin joproporcional të kërkesave për certifikim dhe licencim profesional.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Shkeljet e evidentuara në këtë procedurë të prokurimit jo vetëm që dëmtojnë operatorët ekonomikë përmes kufizimit të konkurrencës dhe favorizimit të operatorëve të caktuar, por paraqesin edhe rrezik serioz për dëmtim të buxhetit publik të Komunës së Glllogocit.**

**Për më tepër, përzierja në një kontratë e profileve të ndryshme si inxhinierë të licencuar, staf administrativ dhe punëtorë mirëmbajtjeje me shkollim të mesëm, pa ndarje të qartë të strukturës financiare dhe pa specifikim të pagesës sipas profileve**

përkatëse, krijon mungesë të plotë transparence mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve publike dhe pamundëson vlerësimin real të kostos së tregut për secilin shërbim.

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*